



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E APLIKANTËVE
TË ARSIMIT PARASHKOLLOR
2015**

I. HYRJE

Programi orientues për testimin e aplikantëve të arsimit parashkollor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në këtë nivel. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të aplikantit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për aplikantët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- Dokumentacioni zyrtar¹ i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- standardet dhe programet e parashkollorit;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënien në arsimin parashkollor;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtjen shkencore të kurrikulës së arsimit parashkollor.

II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e aplikantëve të arsimit parashkollor është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

t'u ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve dhe mësuesve të këtij cikli në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së aplikantëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë mësimore-edukative;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në kopsht;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës parashkollore.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e aplikantëve të arsimit parashkollor është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, krahas kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i arsimit parashkollor.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, që lidhen me kompetencat e secilës fushe të testimit, do ta ndihmojnë aplikantin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, si dhe literatura përkatëse rekomanduese në funksion të tyre.

FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR	
Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar

<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e fëmijës; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. - Udhëzim nr. 25, datë 17.08.2015 “Për vitin shkollor 2015-2016 në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar””. - Udhëzim nr. 5, datë 25.02.2013 “Për standardet e mësuesit”. - Udhëzimi nr. 26, datë 15.08.2015 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”. - Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. - Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes të arsimit parashkollor
--	--

FUSHA: PROGRAMET LËNDORE	
Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të arsimit parashkollor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon standardet e përmbajtjes në arsimin parashkollor – fushat, treguesit cilësorë, fushat e veprimtarisë edukative në kopsht etj; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza Kurrikulare 2014. - Kurrikula bërthamë nga klasa përgatitore deri në klasën e pestë 2014 - Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes të arsimit parashkollor

<ul style="list-style-type: none"> - zbaton programet duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tyre; - përshtat programet në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programeve; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në programe; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e fëmijëve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve nga njëri grup në tjetrin); - përzgjedh materialet dhe mjetet mësimore didaktike të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kërkesave të programeve; - siguron informacion që demonstroi integrimin ndërlëndor; - analizon elementet që i bashkojnë dhe i dallojnë programet e ndryshme edukative që zhvillohen në kopshtet shqiptare; - krijon ura bashkëpunimi, partneriteti dhe bashkëveprimi ndërmjet kopshtit e prindërve të fëmijëve sipas kërkesave që parashtrihen në Standardet e përmbajtjes. 	<ul style="list-style-type: none"> - Programet aktuale të arsimit parashkollor
---	---

<p style="text-align: center;">Kompetenca I</p> <p style="text-align: center;">“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien në arsimin parashkollor”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - mban parasysh karakteristikat e zhvillimit tërësor të fëmijëve të moshës 3-6-vjeçare; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të fëmijëve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me fëmijët; - menaxhon situata, sjellje dhe veprime të ndryshme që paraqesin fëmijët; - zbaton praktika pedagogjike në përshtatje me temën mujore, javore dhe ditore; - identifikon fëmijët me nevoja të veçanta (me vështirësi në të nxënë dhe të talentuarit); - motivon fëmijët me mënyra të ndryshme duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për fëmijët e grupit; - Ndhmon fëmijët për përzgjedhjen e punimeve që duhet të futen në portofolin e të nxënit, të cilat dëshmojnë interesin e tyre për të nxënë. - prezanton materiale të ndryshme duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Word, etj.; - gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe lehtësuar të nxënë të fëmijëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes të arsimit parashkollor - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit në kopsht/ klasa përgatitore.

Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e integruar të arsimit parashkollor”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një rezultati të caktuar; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur, krijues, imagjinatën dhe fantazinë e fëmijëve; - planifikon mësimdhënien e integruar duke pasur në qendër të vëmendjes fëmijën; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të fëmijëve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - mat dhe vlerëson në mënyrë sistematike progresin e fëmijëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit në kopsht/ klasa përgatitore.

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	
Kompetenca “Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, ndihmës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat, 30.11.2013 - Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

<p>sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, ndihmës, fëmijët, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</p>	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e integruar të arsimit parashkollor”	Literatura ² e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arsimit parashkollor:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron konceptet shkencore, dukuritë, ligjësitë që trajtohen në arsimin parashkollor në nivel shkencor dhe didaktik; - përshkruan përshkallëzimin vertikal dhe horizontal të koncepteve dhe shprehive lëndore; - transmeton te fëmijët parashkollorë ato njohuri, shprehje, aftësi dhe vlera që janë në 	<ul style="list-style-type: none"> - Programi i arsimit parashkollor për 3-4-vjeçarët, IKS, 2007 - Programi i arsimit parashkollor për 4-5-vjeçarët, IKS, 2007 - Programi i arsimit parashkollor për 5-6-vjeçarët, IKS, 2007 - Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes të arsimit parashkollor - Botime ndihmëse për fëmijët parashkollorë, mësuesit parashkollor, buletine dhe materiale të

² Mësuesi mund të shfrytëzojë botime të ndryshme që gjenden në bibliotekë, të botuara nga organizata të ndryshme që veprojnë në fushën e edukimit ose në librari, konform kërkesave të kësaj fushe.

<p>përputhje me zhvillimin e tyre dhe me kërkesat e programeve;</p> <p>- zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme ushtrime, kërkesa, situata problemore, eksperimente etj.</p>	<p>tjera burimore që trajtojnë përmbajtjen e kurrikulës për fëmijët parashkollorë.</p>
---	--